

LIGJ

Nr.7624, datë 14.10.1992

PER ADERIMIN NE PROTOKOLLET SHITESI TE KONVENTES
SE GJENEVES TE VITIT 1949

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë
29.4.1991, "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin
e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Neni 1

Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin shtesë
të konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 në lidhje me
mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura ndërkombëtare
(Protokolli I) dhe në Protokollin shtesë të konventave të
Gjenevës të 12 gushtit 1949 në lidhje me mbrojtjen e viktimave
të konflikteve të armatosura jondërkombëtare (Protokolli II), të
miratuara në Gjenevë të Zvicrës në Konferencën Diplomate më
7.6.1977.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.333, datë 28.10.1992 të Presidentit të
Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha